AKTNORMATIV
Nr.35, datë 16.12.2020

PËR NJË SHTESË NË AKTIN NORMATIV NR.1, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MASAT PARANDALUESE NË KUADËR TË FORCIMIT TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMEVE TË RËNDA DHE KONSOLIDIMIT TË RENDIT E SIGURISË PUBLIKE", MIRATUAR ME LIGJIN NR.18/2020

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas paragrafit të parë, të nenit 38, të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Kërkesat për marrjen e masave parandaluese, të depozituara nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit deri në datën 31.12.2020, vazhdojnë të shqyrtohen nga gjykata dhe prokuroria kompetente, të përcaktuara në nenin 9, sipas kompetencës, rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë akt normativ.".

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe